



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ÇËRRIK

Data: 25.05.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Rikualifikim urban i bllokut nr.2 lagjja nr.1 dhe Sistemim Asfaltimi i rrugeve ne Nj.a Mollas, Klos, shales”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për rrugë 45233120-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 138,929,401 *(njqind e tridhjetë e tete milion e nentqind e njetëzete e nente mije e katerqind e nje) leke pa TVSH .*

Perllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike eshte kryer nga inxhinier i bashkise referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”,

Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”

- Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia CERRIK** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit

Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kriterëve të përgjithshme të perzgjedhjes/kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të vënë në dispozicion.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë 41.Riformuluar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 43 Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 46 intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 44 . 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autori. Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij

kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” dhe nenit 29, pika 1, të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit** është **jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

***Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.** Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- Aktin e kolaudimit

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
- Akt kolaudimi objekti

Shënim: *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo më të vogël se 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

Kategoritë e mëposhtme:

Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
NP-1- B	Punime gjurmimi në tokë
NP-4- C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
NP-5- B	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
NP-9- B	Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime
NP-11-A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
NP-12-B	Punime të inxhinierisë së mjedisit
NS-5-B	Impiante të sinjalistikës ndricuese të trafikut
NS-6- A	Sinjalistika rrugore jondriçuese
NS-7-B	Barriera dhe mbrojtja rrugore
NS-9-A	Punime strukturore speciale
NS-18- A	Punime topogjeodezike

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat

për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1- B	<i>Punime gjurmimi në tokë</i>	<p>V. Sistemim asfaltim i rruges "Duzhallareve,Gjolit "dhe "Odave Klos"</p> <p>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet</p> <p>I. Rikualifikim urban I bllokut nr.2 Lagja nr.1 Cerrik</p> <p>3.89/b Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet.</p> <p>5 - PUNIME PER KANALIZIMET E UJRAVE TE NDOTURA KUN</p> <p>3.89/a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet m³ etj</p>	B	21-50 milion leke
NP-4- C	<i>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale</i>	<i>Kemi te bëjmë me rikualifikimin e disa rrugeve prandaj eshte e domosdoshme licensa NP-4 Rikualifikim urban i bllokut nr.2 lagjja nr.1 dhe Sistemim Asfaltimi i rrugeve ne Nj.a Mollas, Klos, shales</i>	C	51 – 100 milion lekë

NP-5- B	<i>Punime nëntokësore, ura, vepra arti</i>	<p>6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME</p> <p>3.396/1 Mbushje me zhavorr pas mureve</p> <p>3.355 Tombino me tuba betoni, shtrese zhavori Ø 300mm</p> <p>2.519 F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 90</p>	B	21-50 milion leke
NP-9- B	Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime	<p>PUNIME PER KANALIZIMIN E UJRAVE TE NDOTUR</p> <p>3.89/a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, token zak, kategoria III, me shk me mjet</p> <p>2.37/5b Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km</p> <p>Analize F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=160mm (perفشire mbushjen me rere)</p> <p>Analize F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm (perفشire mbushjen me rere)</p> <p>3.164/1t F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm (perفشire mbushjen me rere)</p> <p>3.164/2t F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm (perفشire mbushjen me rere)</p> <p>2.336 Pusete shkarkimi 80 x 80, h=0.8÷1.5m, me kapak gize</p> <p>2.599 F.V. Pusete shkarkimi 100x100, h=1.5÷2.0m, me kapak gize</p> <p>3.396/1 Mbushje me zhavorr mbi tuba</p>	B	21-50 milion leke
NP-11-A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja TN e të mesëm	<p>An F.v Tub fleksibel me dy shtresa 2x90mm (linje rezerv)</p> <p>An F.v Tub fleksibel me dy shtresa 63mm (ndricim)</p>	A	0-20 milion leke

	dhe shpërndarjen e energjisë	2.261/a Nenshtrese rere 2.611 F.V. Tub PVC Ø 200mm (per inkastrimin e shtylles) 2.262/3 Beton C 12/15 (per shtyllat) 3.408 F.V. Tuba metalik D=219mm (intersektimet me rrugen)		
NP-12-B	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Sipas percaktimeve ne preventiv.	B	21-50 milion leke
NS-5-B	Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut	PUNIME INSTALIMI PER NDRICIMIN An F.v Tub fleksibel me dy shtresa 2x90mm (linje rezerv) An F.v Tub fleksibel me dy shtresa 63mm (ndricim) 2.261/a Nenshtrese rere 2.611 F.V. Tub PVC Ø 200mm (per inkastrimin e shtylles) 2.262/3 Beton C 12/15 (per shtyllat) 3.408 F.V. Tuba metalik D=219mm (intersektimet me rrugen)	B	21-50 milion leke
NS-6- A	Sinjalistika rrugore jondriçuese	7. B. SINJALET HORIZONTALE 3.942/3 Vijezim shirita gatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm, Termoplastike (sprajt) 3.954 F.V. Tabela rrugore treguese 60x20cm 3.955 F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm 3.933 F.V. Tabela tetekendore e vogel me A-B, 60-20 3.936 F.V. Tabela trekendore e vogel me A = 60 3.932/1 F.V. Tabela katrore normal me diagonal vertikal 60x40 3.942 Vijezim shirita	A	0-20 milion leke

		<p><i>gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (sprajt)</i> 3.946 <i>Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Bikomponente (sprajt)</i> 3.948 <i>F.V. Kurrize artificiale h =3cm</i></p>		
NS-7-B	Barriera dhe mbrojtja rrugore	<p>3.954 <i>F.V. Tabela rrugore treguese 60x20cm</i> 3.955 <i>F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm</i> 3.933 <i>F.V. Tabela tetekendore e vogel me A-B, 60-20</i> 3.936 <i>F.V. Tabela trekendore e vogel me A = 60</i> 3.932/1 <i>F.V. Tabela katrore normal me diagonal vertikal 60x40</i> 3.942 <i>Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (sprajt)</i> 3.946 <i>Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Bikomponente (sprajt)</i> 3.948 <i>F.V. Kurrize artificiale h =3cm</i></p>	B	21-50 milion leke
NS-9-A	Punime strukturore speciale	<p>8. <i>PUNIME SHTRESASH 2</i> 2.262/1 <i>Shtrese betoni C 7/10</i></p>	A	0-20 milion leke
NS-18- A	Punime topogjeodezike	<p>3.211 <i>Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri</i> 3.211 <i>Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri</i> 3.212/b <i>Shtrese stabilizant t=10cm</i> 3.222/2 <i>Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri</i> 3.226/1 <i>Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri</i></p>	A	0-20 milion leke

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “ Grumbulim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dhera si mbetje te parrezikshme ” ,konkretisht kodet:17 01 01, 17 05 04, 17 05 08, 17 09 04 . Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat,autorizimetdhe lejet ne Republiken e Shqiperise”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

2.3.4 Oe duhet te disponoje personelin kryesor **drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomik duhet të paraqese përpara njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar te parashikuar ne shkronja ”a” ”b” ”c” etj si dhe dokumentat shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Percaktimi i kërkeses per Drejtuesin

Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetem për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

1 (një) Inxhinier Ndërtimi- është i domosdoshëm për të ndjekur punimet e ndërtimit

1 (një) Inxhinier Hidroteknik- është i domosdoshëm për të ndjekur punimet hidroteknike e në preventivin fillestar e përkatesisht në zerat :

Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km
F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, t = 3.7 mm, Pn 10
F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, t = 4.7 mm, Pn 10
F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=75mm, PN10
F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=90mm, t = 6.7 mm, Pn 10
Nenshtrese rere
F.V. Saracineska gize me flanaxha , Pn deri 16 bar, φ50
F.V. saracineska gize me flanaxha , Pn deri 16 bar, φ65
F.V. saracineska gize me flanaxha , Pn deri 16 bar, φ80
F.V Hidrant Dn80, Pn16
Ndërtim Pusete kontrolli b/a 1x1x1.5 m

1 (një) Inxhinier Elektrik- është i nevojshëm për të ndjekur punimet elektrike të përcaktuara në preventivin fillestar e përkatesisht në zerat :

F.v Tub fleksibel me dy shtresa 2x90mm (linje rezerv)
F.v Tub fleksibel me dy shtresa 63mm (ndricim)
Nenshtrese rere
F.V. Tub PVC Ø 200mm (për inkastrimin e shtyllës)
Beton C 12/15 (për shtyllat)
F.V. Tuba metalik D=219mm (intersektimet me rrugen)
12. LINJA T/U 0 4-10 KV. SHTYLLA ME LENDE TE CENTRIFUGUARA
Heqje dhe vendosje shtylla b/a, H=8.0m, (Referuar analizes 3.527)

1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet- është i domosdoshëm për të studiuar terrenin e tokës në të cilët do të ndërtohen rrugët për të kuptuar nëse terreni nuk rreshket

1 (një) Inxhinier Mekanik- eshte i domosdoshem per te ndjekur punimet mekanike ne preventivin fillestar e perkatesisht ne zerat:

	11. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE
2.519	F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 90

1 (një) Inxhinier Mjedisi -- është përgjegjës për mbarevatjen e të gjitha punimeve dhe sigurimin që punimet e kryera mos cenojnë kushtet dhe parametrat mjedisore të terrenit dhe të kënaqësisë sa më të vogël në mjedis.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 150 (**njeqind e pesedhjetë**) **persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri,

operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin e fundit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për muajin e fundit.

Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomik duhet të paraqesë përpara njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar të parashikuar në shkronja "a" "b" "c" etj si dhe dokumentat shoqeruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit, orëve të punës (8 ore në ditë për cdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës (120 ditë) si dhe shpërndarjes së punës.

2.3.6 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili Gjeoteknike)

1 (një) Inxhinier Gjeolog

1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomik duhet të paraqese përpara njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar te parashikuar ne shkronja "a" "b" "c" etj si dhe dokumentat shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkeses për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

Inxhinier ndertimi – eshte i domosdshem per te ndjekur punimet e ndertimit qe percaktohen ne preventivin fillestar.

Inxhinier Gjeolog- eshte i domosdoshem per te studiuar terrenin e tokes ne te cilet do te ndertohen rruget per te kuptuar nese terreni nuk rreshket.

Inxhinier topograf- eshte i domosdoshem per te kryer piketimet dhe matjet topografike te punimeve.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar (te provuar me dokumentacionin e specializimit/kualifikimit nga institucione te akredituara ne RSH si dhe te jene ne listepagesen e operatorit se paku ne listepagesen e muajit te fundit) për kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit te punimve, si më poshtë:

Teknik Ndërtimi	Jo me pak se	3
Hekurthyes	Jo me pak se	5
Kaperntier	Jo me pak se	5
Elektriçist	Jo me pak se	2
Hidraulik	Jo me pak se	5
Pllakashtrues trotuari	Jo me pak se	5
Punonjes Bordurash	Jo me pak se	5
Punonjes asfalti	Jo me pak se	15

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar:

Manvratore/Eskavatoriste	Jo me pak se	10
Manvratore/Buldozerist	Jo me pak se	5
Automakinist	Jo me pak se	5
Shofer	Jo me pak se	10

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomik duhet të paraqese përpara njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar te parashikuar ne shkronja "a" "b" "c" etj si dhe dokumentat shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: (Dëshmi te Aftesise Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores., Kontratat e punës individuale të vlefshme si dhe te jene ne listeprezenca e OE se paku muajin e fundit.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, të nevojshme për

ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Teknik Ndërtimi- është i domosdoshem për të ndjekur punimet ndërtimore të përcaktuara NE PREVENTIV.

Hekurthyes- është i domosdoshem për lidhjen dhe vendosjen e hekurit në preventivin fillestar e përkatesisht në zerat:

5. PUNIME HEKUR BETONI 3	
3.287	F.V. Hekur betoni i zakonshëm Ø 6 ~ 10mm

Kaperntier -është i domosdoshem për ndjekjen e punimeve në preventivin fillestar.

Elektriçist- është i domosdoshem për ndjekjen e punimeve në preventivin fillestar si:

An	F.v Tub fleksibel me dy shtresa 2x90mm (linje rezerv)
An	F.v Tub fleksibel me dy shtresa 63mm (ndricim)
2.261/a	Nenshtrese rere
2.611	F.V. Tub PVC Ø 200mm (për inkastrimin e shtyllës)
2.262/3	Beton C 12/15 (për shtyllat)
3.408	F.V. Tuba metalik D=219mm (intersektimet me rrugën)

Hidraulik- është i domosdoshem për të kryer punimet që përcaktohen në preventivin fillestar si: **5 - PUNIME PËR KANALIZIMET E UJRAVE TË NDOTURA KUN**

Punime

Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km
F V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=160mm (përfshirë mbushjen me rere)
F V tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=250 mm (përfshirë mbushjen me rere)
F.V. Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=315 mm (përfshirë mbushjen me rere)
F.V. Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=400 mm (përfshirë mbushjen me rere)
Pusete shkarkimi 80 x 80, h=0.8÷1.5m, me kapak gize
F.V. Pusete shkarkimi 100x100, h=1.5÷2.0m, me kapak gize
Mbushje me zhavor mbi tuba
6- PUNIME PËR UJESJELLESIN
Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet
Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km

F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, t = 3.7 mm, Pn 10
F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, t = 4.7 mm, Pn 10
F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=75mm, PN10
F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=90mm, t = 6.7 mm, Pn 10
Nenshtrese rere
F.V. Saracineska gize me flanaxha , Pn deri 16 bar, φ 50
F.V. saracineska gize me flanaxha , Pn deri 16 bar, φ 65
F.V. saracineska gize me flanaxha , Pn deri 16 bar, φ 80
F.V Hidrant Dn80, Pn16
Ndertim Pusete kontrolli b/a 1x1x1.5 m

Pllakashtrues trotuari-eshte i domosdoshem per kryerjen e punimeve si me poshte:

3.616	F.V. Bordura betoni 12x25cm
3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (per fiksimin e bordures + kunete)
3.243	Struktura monolite betoni C 16/20

Punonjes Bordurash- eshte i domosdoshem per kryerjen e punimeve si

3.616	F.V. Bordura betoni 12x25cm
3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (per fiksimin e bordures + kunete)
3.243	Struktura monolite betoni C 16/20

Punonjes asfalti- eshte i domosdoshem per punimet e asfaltit qe do te kryhen ne te gjitha rruget e Bashkise Cerrik.

Manovrate/Eskavatoriste- jane te domosdoshem per shkak te mjeteve te kerkuara per shkak se jane disa rruge te cilet do te asfaltohen.

Manovrate/Buldozerist- jane te domosdoshem per shkak te mjeteve te kerkuara per shkak se jane disa rruge te cilet do te asfaltohen.

Automakinist- jane te domosdoshem per shkak te mjeteve te kerkuara per shkak se jane disa rruge te cilet do te asfaltohen.

Shofer – jane te domosdoshem per shkak te mjeteve te kerkuara per shkak se jane disa rruge te cilet do te asfaltohen.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomik duhet të paraqesë përpara njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar të parashikuar në shkronja “a” “b” “c” etj si dhe dokumentat shoqeruese të ofertës të dorezuara në rrugë elektronike.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, *mpunëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.10 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (*Inxhinier Ndërtimi me eksperiencë*) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe ***nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.***

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas Shtojcës 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, librezë pune dhe kontratë pune.***

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit,

klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajftueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknik të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1)	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 5</i>
2)	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
3)	<i>Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 5</i>
4)	<i>Kamion me vinç me kapacitet mbi 10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
5)	<i>Fadromë me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>
6)	<i>Grejder</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
7)	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
8)	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
9)	<i>Autopompë betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
10)	<i>Autobitumatriçe</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
11)	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
12)	<i>Minifadrome</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
13)	<i>Minieskavator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
14)	<i>Eskavatorë me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
15)	<i>Eskavatorë me zinxhir</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
16)	<i>Rul gomë-hekur</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
17)	<i>Rul hekur-hekur</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>
18)	<i>Makineri vijëzimi</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
19)	<i>Freze asfalti</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
20)	<i>Prerese asfalti</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
21)	<i>Betoniere kantieri</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
22)	<i>Moto gjenerator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
23)	<i>Elektrosaldatriçe</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
24)	<i>Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
25)	<i>Matrapik</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
26)	<i>Makineri për vendosje guardrail</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
	<i>Autokompresor</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fitues.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 *Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- SSH EN ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*
- SSH EN ISO 14001:2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*
- SSH EN ISO 45001:2023 *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kërkesa per keto certifikata eshte bere pasi jane të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001:2015 - Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës.

ISO 45001: 2018 – Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojtë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

ISO 14001-2015- Eshtë standarti më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të mjedisit. Rikonstruksioni I objektit konkret, përveçse kërkon një kapacitet me makineri kanë edhe një ndikim në mjedis për shkak të kushteve në të cilat realizohen si ndotja e ajrit nga pluhurat e kantierit ndotja akustike dhe mjedisore nga makinerite etj, aq me teper qe kemi te bejme me dy objekte brenda ne qytet. Për këtë arsye cdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e ambjentit. Eshtë në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

2.4.2 *Grafiku i punimeve.*

2.4.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).*

Specifikimet teknike janë hartuar ne zbatim te nenit 36 te ligjit nr.162/2020 “ Per prokurimin Publik” dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratrimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinier i licensuar dhe do te bashkengjiten dokumentave te tenderit ne SPE.

NJESIA E PROKURIMIT
